



RELACION TEKNIK

***OBJEKTI: Rikonstruksioni i rrjetit TU me kablllo
me vetëmbajtje ABC në zonat rurale të Tiranës***



PËRMBAJTJA

1.	INFORMACION I PËRGJITHSHËM.....	3
2.	HYRJE	4
2.1.	Objekti i Relacionit Teknik	5
2.2.	Referimet Ligjore dhe Teknike	5
2.2.1.	Referimet ligjore	5
2.2.2.	Referimet teknike	6
3.	KERKESAT AMBIENTALE DHE PARAMETRAT ELEKTRIK TE SISTEMIT	7
4.	ZONA E PROJEKTIT	8
4.1.	Pozicioni Gjeografik	8
4.2.	Abonentët	8
5.	GJENDJA EKZISTUESE DHE KËRKESA PËR ENERGJI	9
5.1.	Rrjeti elektrik ekzistues	9
6.	PROJEKTI I RI 20 kV	9
6.1.	Domosdoshmeria, arsyeja e kryerjes se investimit	9
6.2.	Metodologjia e projektimit	9
6.2.1.	Fazat e projektit të zbatimit	10
6.2.2.	Kriteret e projektimit	15
6.2.3.	Percaktimi i rrymes maksimale te zgjatimit te fiderit	16
6.3.	Kabinat e transformacionit 20/0.4 kV	16
	Referencat	18



1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

EMERTIMI	Rikonstruksioni I rrjetit TU me kablo me vetembajtje ABC ne zonat Rurale te Tiranes		
VLERA E PROJEKTIT	149.839.593,8	lekë	pa TVSH
INVESTITOR	OSSH sh.a.		
PROJEKTUES	OSSH sh.a.		
	Ing. Elektrik :		
	Ing. Elektrik :		
	Ing. Elektrik:		
	Ing. Elektrik:		
	Ing. Elektrik:		
	Ing. Elektrik :		
	Ing. Elektrik :		
	Ing. Elektrik :		
	Ing. Elektrik :		
	Ing. Elektrik :		
BURIMI I FINANCIMIT	OSSH sh.a.		
BAZA MATERIALE KRYESORE			
Numri i fiderave të rinj dhe emërtimi:	Rikonstruksioni I rrjetit TU me kablo me vetembajtje ABC ne zonat Rurale te Tiranes		
Numri i kabinave:			
Numri i transformatorëve:			
Gjatësia e linjës TM:			
	Kablo ABC me vetëmbajtje total: 42.5 km		
Gjatesia e linjave TU:	Haskolje, Allgiate, Kus, - 15.475km Marikaj ,Preze,Zallherr – 13.533 Berxulle - 5.750 km Erjoni - Rrodhe, Veski , 7.8 - km		
	Total 990 abonentë		
Numri abonentëve të prekur nga investimi:	Haskolje, Allgiate, Kus - 300 abonentë Marikaj,Preze,Zallherr– 400 Berxulle - 210 abonentë. Erjoni - Rrodhe ,Veski , 80 abonentë.		
Karakteristikat kryesore të abonentëve në zonë:	Zona e projektit përbëhet kryesisht nga konsumatorë familjarë me gati 80% të abonentëve total, 20% e abonentëve janë konsumatorë privat, dhe 0% janë konsumatorë buxhetorë, jobuxhetorë dhe institucione kulti.		
Sipërfaqe totale e zonës së përfshirë në projekt:	17.1 km ²	(3.5 km ² , 2.2 km ² 4.2 km ² 7.3 km ²)	
Qëllimi i realizimit të projektit	Me realizimin e këtij projekti synohet zvogëlimi i humbjeve në zonën e përfshirë si dhe përmirësimi i treguesve të performancës SAID dhe SAIF. Dhe Realizimi i këtij investimi është detyrim ligjor pasi rrjeti elektrik në këtë zonë është jashtë kushteve teknike dhe përbën rrezik për abonentët dhe banorët e zonës.		



Humbjet ne rrjet per fiderin 101 N/St. Mezez qe furnizon fshatrat Haskolje Allgjate dhe Kus:

Humbjet ne rrjet per fiderin 141 N/St Valias qe furnizon fshatin Berxulle:

Humbjet ne rrjet per fiderin E 5 N/St Farke qe furnizon fshatrat Rrodhe dhe Veski.

E 5 N/St Farke - 16.4 %

Humbjet ne rrjet per fiderin Vore, Gjokaj, Preze, N/St. Vore, Fiderat A21 dhe A24 N/St. Rajonal qe furnizon fshatrat Marikaj, Preze, Zall-Herr

Fideri Gjokaj - 9.6 %

Fideri Vore - 21.6 %

Fideri Preze - 38.3 %

Fideri A21 - 14.5 %

Nr	Fider	N/st	SAIFI	SAIDI (ore)
1	F 101	Mezez	21.26	33.38
2	F141	Valias	42.61	97.25
3	E5	Farke	46.64	169.0
4	Vore	Vore	4	7.32
5	Gjokaj		14.61	36.44
6	Preze		17.79	23.3
7	A21	Rajonal	20.06	23.15
8	A24		32.37	54.08

2. HYRJE

- Qyteti i Tiranës dhe zona periferike e tij karakterizohen nga një zhvillim intensiv i gjithanshem, vecanerisht i ndertimeve, per shkak te zhvendosjes ne kete hapësire te popullsisë.
- Zonat rurale te qytetit te Tiranës, kryesisht fshatrat Haskolje, Allgjate , Kus, Berxulle, Rrodhe,Veski, Marikaj ,Gjokaj,Preze ,Zallherr, jane fshatra te cilat kane mare një zhvillim nga vete banoret.
- Ndryshimet që kane ndodhur duke përfshirë edhe këto zona rurale, kane modifikuar rrënjësisht funksionin e fshatrave nga zona rurale ne zona urbane te zhvilluara, kjo ka ndryshuar rrënjësisht përbërjen sociale dhe strukturën urbanistike te tyre.

- d) Keta faktore kane bere qe ritmet e rritjes se kerkeses per energji elektrike per fshatrat dhe per zonat te jene mjaft te larta. Eshte e qarte qe per ti paraprire nevojave per furnizimin me energji elektrike te këtyre zonave të qytetit te Tiranës, duhet zhvilluar nje infrastrukture elektrike e pershtatshme, qe te garantoje nje sherbim cilesor kundrejt konsumatoreve aktuale dhe njekohesisht te jete ne perputhje me zhvillimet e pritshme afatgjata te fshatrave dhe zonave ku do implementohet projekti.
- e) Referuar strategjisë së zhvillimit dhe përmirësimit të rrjetave elektrike që Kompania OSSH ka, ndër të tjera dhe :
- Zëvendësimi i rrjetit aktual 6/ 10 kV nëpërmjet ndërtimit të rrjetit me izolacion 20 kV të tensionit të mesëm.
 - Ne perspektive per rregullimin e ngarkesave te fiderave unazore ekzistuese te ngarkuar duke i lidhur ne unaze me fidera te rinj.
 - Balancimin e ngarkesave në N/stacione, linja TM, kabina transformacioni dhe rrjetin TU,
 - Rikonstruksionin e linjave te furnizimit te abonenteve, nga rrjeti aktual ekzistues me tel Al-C te amortizuar nder vite me kabell me vetembajtje ABC.

2.1. Objekti i Relacionit Teknik

Objekti i Raportit Teknik të Projektit është për të përmbledhur konceptin dhe kriteret e projektimit të përdorura për hartimin e projektit të detajuar dhe dhënë rezultatet e projektit të detajuar për ndërtimin e rrjetit elektrik të zonave Haskolje , Allgjata, Kus, Bexulle , Baldushk, Mucaj, Isufkocaj, Veski, Marikaj ,Gjokaj,Preze ,Zallherr.

2.2. Referimet Ligjore dhe Teknike

2.2.1.Referimet ligjore

- Ligji Nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”
- Vendimi i ERE nr.100, date 26.8.2008 “Kodi i Shperndarjes”
- Vendimi i ERE nr.101, date 2.8.2008 “Kodi Matjes”
- ERE “Per Lidhjet e Reja ne Sistemin e Shperndarjes”
- “Rregullore e Sigurimit dhe Shfrytezimit Teknik per Impiantet, Instalimet dhe Pajisjet Elektrike”
- Vendim i KM nr.312, datë 5.5.2010 Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”
- Vendim i KM nr.564, datë 3.7.2013 Për miratimin e rregullores “Për kerkesat minimale te sigurise dhe shendetit ne vendin e punes”

- VKM 482 17.6.2020 “Për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së linjave elektrike me tension të lartë mbi 1 kV”
- VKM 483 17.6.2020 “Për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së instalimeve elektrike të tensionit të lartë, mbi 1 kV”
- Ligji nr.8405, date 17.9.1998 “per Urbanistiken”
- Ligji nr.8402, date 10.9.1998 “per Kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”
- Ligji Nr. 10 440,dt 7.7.2011 “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis”
- Ligji Nr.9537 date 18.05.2006 “Per Administrimin e Mbetjeve te Rrezikeshme (i permiresuar me LigjinNr.9890 date 20.03.2008)”
- Ligji nr. 8934, date 5.9.2002 “per Mbrojtjen e mjedisit”
- Ligji nr. 8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”
- VKM Nr.249, dt 24.04.2003 “Për Miratimin e Dokumentacionit për Leje Mjedisore dhe të Elementeve të Lejes Mjedisore”

2.2.2. Referimet teknike

Puna duhet të kryhet në përputhje me kodet, standartet, rregullat për parandalimin e incidenteve. Puna duhet të përmbushë standartet e permendura me sipër dhe praktikatat e rekomanduara. Referimet teknike kryesore janë:

- SSH EN 60947 Pajisjet shpërndarëse dhe te kontrollit të tensionit të ulët (Low-voltage switchgear and controlgear)
- S SH EN 50274:2002: Tërësia e pajisjeve shpërndarëse të tensionit të ulët - Mbrojtja nga goditja elektrike - Mbrojtja nga kontakti i drejtpërdrejtë i paqëllimshëm me pjesët e rrezikshme nën tension
- SH EN 50274:2002/AC:2009: Tërësia e pajisjeve shpërndarëse të tensionit të ulët - Mbrojtja nga goditja elektrike - Mbrojtja nga kontakti i drejtpërdrejtë i paqëllimshëm me pjesët që përbejnë rrezik për jetën
- SSH EN 60898-2:2006: Ndërprerësit e tensionit për mbrojtjen nga mbirrymat për instalimet shtëpiake dhe të ngjashme me to — Pjesa 2: Ndërprerësit e qarkut për veprimin e rrymës alternative dhe rrymës së vazhduar
- SSH EN 60947-5-4:2003:Pajisjet shpërndarëse të tensionit të ulët - Pjesa 5 - 4: Pajisjet e qarkut të kontrollit dhe elementët ndërprerës - Metoda e vlerësimit të performancës së kontakteve me energji të ulët - Prova të veçanta (ose ekuivalentet e tyre)
- SSH HD 361 S3:1999 Sisteme për projektimin e kablllove
- SSH HD 361 S3:1999/A1:2006
- SSH HD 361 S3:1999/AC: 1999
- SSH HD 516 S2:1997: Udhezues për përdorimin e kablllove të harmonizuara të tensionit të ulët
- SSH HD 516 S2:1997/A1:2003
- SSH HD 516 S2:1997/A2:2008
- SSH HD 603 S1:1994: Kabllot e shpërndarjes me tension të vlerësuar 0,6/1 kV
- SSH HD 603 S1:1994/A1:1997
- SSH HD 603 S1:1994/A2:2003
- SSH HD 603 S1:1994/A3:2007



- SSH HD 604 S1:1994: Kabllot e fuqise 0,6/1 kV dhe 1,9/3,3 kV me performance speciale ndaj zjarrit per perdorim ne stacionet dektrike
- SSH HD 604 S1:1994/A1:1997
- SSH HD 604 S1:1994/A2:2002
- SSH HD 604 S1:1994/A3:2005
- SSH HD 605 S2:2008: Kabllo elektrik - Metodat shtese te proves
- SSH HD 605 S2:1994/AC:2010
- SSH HD 627 S1:1996/A1:2000
- SSH HD 627 S1:1996/A2:2005
- SSH EN 50363-0:2011 Materialet e izolimit, mbuluese dhe veshese per kabllot e energjise me tensioni te ulet – Pjesa 0: Paraqitje e pergjithshme
- SSH EN 50363-3:2005: Materalat e izolimit, veshjes dhe mbulimit per kabllot elektrik te tensionit te ulet - Pjesa 3: Materalat elektroizoluese prej PVC-je
- S SH EN 50363-4-1:2005: Materalat e izolimit, veshjes dhe mbulimit per kabllot elektrik te tensionit te ulet - Pjesa 4-1: Materalat veshese prej PVC-je
- S SH EN 50363-4-2:2005: Materalat e izolimit, veshjes dhe mbulimit per kabllot elektrik te tensionit te ulet - Pjesa 4-1: Materalat mbuluese prej PVC-je
- SSH EN 50395:2005: Metodat elektrike te testimit per kabllot elektrk te tensionit te ulet
- S SH EN 50396:2005: Metodat jo elektrike te testimit per kabllot elektrk te tensionit te ulet
- SSH EN 60228:2005: Percjellesit e kabllove te izoluar
- SSH IEC 60479 Efektet e rrymë mbi trupin e qënieve njërzore dhe bagëtime

3. KERKESAT AMBIENTALE DHE PARAMETRAT ELEKTRIK TE SISTEMIT

Kerkesat ambientale:

- | | |
|--|----------|
| • Temperatura Max. e ambientit | + 40°C |
| • Temperatura Min. e ambientit | - 20°C |
| • Temperatura Max. mesatare | + 30°C |
| • Temperatura mesatare vjetore ne ajer | + 15°C |
| • Lageshtia Relative Max. | 80 % |
| • Shpejtesia Max. e eres | 130 km/h |
| • Lartesia Max. nga niveli detit | 100 m |

Parametrat e rrjetit TU:

- | | |
|----------------------------------|-------------------------|
| • Tensioni nominal i sistemit | 230/400 V |
| • Tensioni më i lartë i sistemit | 0.66 kV |
| • Numri i fazave | 3 |
| • Frekuenca | 50 Hz |
| • Sistemi i tokezimit | i lidhur direkt ne toke |

Parametrat e rrjetit 20 KV:

- | | |
|----------------------------------|-------|
| • Tensioni nominal i sistemit | 20 kV |
| • Tensioni më i lartë i sistemit | 24 kV |
| • Numri i fazave | 3 |



• Frekuenca	50 Hz
• Sistemi i tokezimit	i izoluar
• Qendrueshmeria ndaj LSH	
○ Nenstacionet Primare	31.5 kA (3s)
○ Kabinat Shperndarese	20 kA (1s)
Distanca minimale e izolimit:	25 mm/kV

4. ZONA E PROJEKTIT

4.1. Pozicioni Gjeografik

Projekti i përgjithshëm shtrihet në gjithë disa zona rurale të Tiranës, kryesisht në zonën e Haskoljes, Allgates, Kusit, zone e cila aktualisht furnizohet nga fideri 101 i N/St. Mezezit,

zona Bërxulles e cila aktualisht furnizohet nga fideri 141 i N/St. Valias.

zona Rrodhe, Veski e cila aktualisht furnizohet nga fideri E5 N/St. Farke.

Zona Marikaj, Gjokaj, Preze, Zallherr. e cila aktualisht furnizohet nga fiderat Vore, Gjokaj, Preze, A21, A24.

Projekti përfshin një zonë gjeografike prej 31 km².

4.2. Abonentët

Zona e përfshirë nga projekti është pjesë e Bashkisë Tiranë, e zhvilluar me ndërtime ekzistuese (para viteve '90), me ndërtime dhe rikonstrukcione të reja. Për këtë fazë të investimit përfshihen rreth 1230 abonentë në total, konkretisht,

300 abonentë (familjarë dhe privatë) në zonën Haskoljes, Allgates, Kusit,

210 abonentë (familjarë dhe privatë) në zonën e Bërxulles

320 abonentë (familjarë dhe privatë) në zonën Baldushkut

400 abonentë (familjarë dhe privatë) në zonën Marikaj, Preze, Zallherr

të cilët kalojnë nga rrjeti i vjetër i amortizuar 6 kV me një linjë të re TU të furnizimi të abonentëve me kabell me vetembajtje ABC.



5. GJENDJA EKZISTUESE DHE KËRKESA PËR ENERGJI

5.1. Rrjeti elektrik ekzistues

Zonat rurale të Tiranës, kryesisht fshatrat Haskolje, Allgiate, Kus aktualisht furnizohen në TM në tension 6kV nga fideri 101 N/Stacioni Mezez, .

Fshati Berxulle aktualisht furnizohen në TM në tension 6 kV nga fideri 141 N/Stacioni Valias.

Fshaterat Marikaj, Preze Zallherr aktualisht furnizohen në TM në tension 6 kV dhe 20 kV nga fiderat Vore ,Preze,Gjokaj nga N/Stacioni Vore dhe fiderat A21, A24 N/Stacioni Rajonal.

Fshatrat Baldushk, Mucaj, Isufkocaj, Veski, aktualisht furnizohen në TM në tension 10 kV nga fideri E5 N/Stacioni Farke .

6. PROJEKTI I RI TU

6.1. Domosdoshmeria, arsyeja e kryerjes së investimit

Ky investim është planifikuar të kryhet për arsye se:

- Zona aktualisht ka humbje të larta
- Zona ka cilesi të dobët të furnizimit me energji elektrike
- Rrjeti shpërndarës në zonë është jashtë kushteve teknike

Përsa më sipër del e nevojshme rritja e cilësisë së shpërndarjes së energjisë elektrike, për këtë qëllim hartohet projekti i rikonstruksionit të linjes TU të ketyre fshatrave. Rrjeti elektrik në këtë zonë ka nevojë për përmirësime pasi gjendja teknike e tij është drejt amortizimit total dhe në disa pjesë plotësisht e amortizuar, zhvillimi urbanistik në këtë zonë ka sjellë rritje të kërkesës për konsum të energjisë elektrike. Rikonstruksioni i rrjetit të tensionit të ulët do të rrisë cilësinë e energjisë së shpërndarë, do të ulë numrin e difekteve, do të garantojë siguri në shfrytëzimin e tij.

6.2. Metodologjia e projektimit

Tipi, struktura dhe principet e projektimit të linjave të furnizimit në TU të zonave të lartpërmendura janë hartuar në mbështetje të detyrës së projektimit të hartuar nga Drejtoria Rajonale Tirane, sipas normave dhe specifikimeve teknike të OSSH sh.a. Projekti i detajuar është tashmë i përgatitur nga Sektori i Projektit në Drejtorinë Rajonale Tirane.

Në këtë projekt, i cili konsiston kryesisht në projektin e detajuar të rikonstruksionit të rrjetit të ri elektrik TU, projektuesi do të ndjekë dhe të zbatojë shumicën e principeve, kritereve dhe kushteve aktuale të zhvillimit urban për realizimin me standartet e kërkuara dhe me kosto të leverdisshme.



Nga ana tjetër, bazuar në rishikimin e studimeve të mëparshme, projektuesi është vënë në dijeni të vështirësive që mund të hasen në aspektin e funksionimit dhe operimit që mund të takohen gjatë fazës së zbatimit të projektit në keto zona.

6.2.1.Fazat e projektit të zbatimit

Elementi strukturor kryesor i projektit është rikonstruksionit të rrjetit të ri elektrik TU me kabell me vetembajtje ABC







Kabina tip kulle Haskolje 2

Foto te fshatrave Haskolje Allgjate dhe Kus





Kabina Vranaj



Rrjeti Tu ekzistues





Kabina Qehaja





Kabina Alush Palaq

6.2.2. Kriteret e projektimit

Kriteret e projektimit që përdoren për të përcaktuar llojin e linjës, tipin e kabllit të përdorur, fuqinë e transformatorëve të kabinave janë prezantuar më poshtë.

1. Përcaktimi i ngarkesës elektrike të pritshme

Nga studimi i zones që do të furnizohet pritet që rikonstruksioni i linjave TU në kabinat shtyllore, tip kulle, box të fiderave 101, N/St. Mezes, E5 N/St Farke, F141 N/St. Valias, Vore, Gjokaj, Preze, Zallherr N/st Vore, Rajonal të kenë një rrymë maksimale në momentin e ndertimit $I_{F1} = 105 \text{ A}$. Në momentin e përfundimit të realizimit të projektit kërkohej që të maten ngarkesat e secilës kabine dhe të dergohej informacioni në drejtorite përkatëse të menaxhimit të rrjetit dhe drejtorise së projektimit me qëllim rrillogaritjen e fiderave të rinj me ngarkesat faktike.

2. Kategoria e konsumatorëve



Nga informacioni i mbledhur nga drejtoria e matjes si dhe azhurnimi rezultojn se ne zonen e projektit jane 990 abonente total sipas kategorive 80% abonente familjar, 20% abonente privat. Ne zonen e projektit nuk kemi konsumator industrial. Kategorite e konsumatoreve ne zone karakterizohen nga nje faktor fuqie prej 0.9 deri me 0.95 per kete arsye ne llogaritjet qe jane kryer ne ngarkesa te ndryshme eshte marre $\cos\phi = (0.9 - 0.95)$.

3. Përcaktimi i ngarkesave ne llogaritje

Gjatë projektimit është marrë në konsiderate që kabinat e transformacionit të ngarkohen deri në 80 % të fuqisë së tyre nominale, gjithashtu per llogaritjen e ngarkese se seciles kabine eshte studiuar dhe ngarkesa e kabinave ekzistuese kur ky informacion ka qene i disponueshem. Ne raste te tjera kur mungon informacioni, jane perdorur edhe koeficientet e njekoheshmerise me qellim llogaritjen e fuqise maksimale qe nje kabine ka ne pik.

Numri i kabinave	k_{nj}
1	1
5	0.9
10	0.85

Table 3: Koeficientet e njekoheshmerise ne varesi te numrit te kabinave¹

6.2.3. Përcaktimi i rrymes maksimale te zgjatimit te fiderit

Përcaktimi i rrymes maksimale te fiderave eshte realizuar ne baze te (VKM-Nr.482-Dt.17.06.2020, 2020) ku perkatesisht jane marre parametrat e me poshtem:

Tipi i izolacionit	XLPE
Temperatura maksimale e lejuar e percjellesit	90°C
Materiali i percjellesit	Al
Seksioni i percjellesit	240 mm ²
Temperatura e tokes	90°C
Rezistenca termike e tokes	1 K.m/W
Numri i linjave kabllore ne nje shtrat d = 0.4 m	2
Thellesia e instalimit te linjave	1 m
Gjatesia me e madhe e linjes se vendosur ne TUB	10 ml
Temperatura maksimale e ajrit	40°C

Table 4: Parametrat teknik te nevojshem per llogaritjen e rrymes maksimale te linjes TM

6.3.Kabinat e transformacionit 20/10/6/0.4 kV

Ky investim ne LTU do te perfshije ne total - 8 Kabina ,

Lista e kabinave te perfshira ne kete investim per rikonstrukcion te rrjetit TU eshte listuar si me poshte:



Nr.	Drejtoria	Njesia	N/Stacioni	Fideri	Niveli Tensionit (kV)	Emertimi I kabines	Fuqia e TR(kVA)	Tipi I Kabines
1	Tirane	Tirana 4	Mezez	101	6	Haskolje 1 varrezat	100	shtyllore
2	Tirane	Tirana 4	Mezez	101	6	Haskolje 2	250	kulle
3	Tirane	Tirana 4	Mezez	101	6	Haskolje 3	250	shtyllore
4	Tirane	Tirana 4	Mezez	101	6	Allgjate	250	shtyllore
5	Tirane	Tirana 4	Mezez	101	6	Allgjate 1	180	shtyllore
6	Tirane	Tirana 4	Mezez	101	6	Allgjate 2	100	shtyllore
7	Tirane	Tirana 4	Mezez	101	6	Kus	400	shtyllore
8	Tirane	Tirana 4	Mezez	101	6	Lgj Sorre	315	Kulle
9	Tirane	Tirana 4	Valias	141	6	Muk	160	Murature
10	Tirane	Tirana 4	Valias	141	6	Drejtoria Ujrave	320	Kulle
11	Tirane	Tirana 4	Valias	141	6	Serat	400	Shtyllore
12	Tirane	Tirana 4	Valias	141	6	Qender Berxulle	320	Kulle
13	Tirane	Tirana 4	Farke	E5	10	Rodhe 1	160	Shtyllore
14	Tirane	Tirana 4	Farke	E5	10	Rodhe 2	160	Shtyllore
15	Tirane	Tirana 4	Farke	E5	10	Isufmucaj	100	Shtyllore
16	Tirane	Tirana 4	Farke	E5	10	Mustafakoc 1	400	Kulle
17	Tirane	Tirana 4	Farke	E5	10	Mustafakoc 2	100	Shtyllore
18	Tirane	Tirana 4	Farke	E5	10	Kocaj	250	Kulle
19	Tirane	Tirana 4	Farke	E5	10	Veski 1	160	Shtyllore
20	Tirane	Tirana 4	Farke	E5	10	Veski 2	160	Shtyllore
21	Tirane	Tirana 3	Vore	Vore	6	Marikaj 1	200	Shtyllore
22	Tirane	Tirane 3	Vore	Vore	6	Marikaj 5	200	Shtyllore
23	Tirane	Tirane 3	Vore	Vore	6	Marikaj 6 Vila	200	Shtyllore
24	Tirane	Tirane 3	Vore	Vore	6	Lagjia Toptani	160	Shtyllore
25	Tirane	Tirane 3	Vore	Vore	6	Gjokaj	200	Shtyllore
26	Tirane	Tirane 3	Vore	Vore	6	Gjokaj	180	Shtyllore
27	Tirane	Tirane 3	Vore	Preze	6	Vranaj	250	Shtyllore
28	Tirane	Tirane 3	Vore	Preze	6	Qehajaja	180	Shtyllore
29	Tirane	Tirane 3	Vore	Preze	6	Terzi	160	Shtyllore
30	Tirane	Tirane 3	Vore	Vore	6	Alush Palaq	160	Murature Kulle
31	Tirane	Tirane 3	Rajonal	A21	20	K39	400	Boks
32	Tirane	Tirane 3	Rajonal	A24	20	K1A24	400	Boks
32	Tirane	Tirane 3	Rajonal	A24	20	K2A24	400	Boks

Shenim: Emertimi i kabinave te reja eshte si me poshte:

- F1 – fideri ne te cilin eshte lidhur kabina
- 01 – numri rendor ku kjo kabine eshte lidhur ne fider
- B – tipi i kabines perkatesisht
 - B – per kabina box



- R – per kabina rikonstruksion
- Sh – per kabina shtyllore
- Per tipologji te tjera kabinash do te shkruhet shkurtimi perkates dhe do te jepet shenim sqarues.
- 2 – fuqia e transformatorit te instaluar ne kabine
 - 2 – per transformator fuqie 250 kVA
 - 4 – per transformator fuqie 400 kVA
 - 6 – per transformator fuqie 630 kVA

Per fuqi te tjera nga te shenuarat me siper do te shenohet fuqia perkatese e transformatorit

- Referencat

DMRR. (2023). *Tabelat 1A*. Tirane: OSHEE.

DPZPS. (2023). *Standartet Teknike OSHEE*. Tirane: OSHEE.

DSHA. (2023). *Faturimet Maj-Arketimet Qershor*. Tirane: OSHEE.

VKM-Nr.482-Dt.17.06.2020. (2020). *VKM Nr. 482 Dt. 17.06.2020*. Tirane: Fletore Zyrtare 120 dt. 26.06.2020.

Zaimi, Q. (2009). *Shpërndarja e energjisë elektrike*. Tiranë, Shqipëri: MALUKA.

GRUPI PROJEKTIMIT

OSSH sh.a.

Ing. Elektrik :

Ing. Elektrik :

Ing. Elektrik:

Ing. Elektrik:

Ing. Elektrik:

Ing. Elektrik :

Ing. Elektrik :

Ing. Elektrik :

Ing. Elektrik :

Ing. Elektrik :

